




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi: Nr. K-07/25

Datë: 25.02.2025

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas Shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit në mbledhjen e datës, 25.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me blerjen e 90 % të aksioneve dhe marrjen e kontrollit të drejtpërdrejtë, nga ndërmarrja SIGAL BUSINESS CENTER Sh.P.K mbi SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.A., përmes UNIQA Osterreich Versicherungen AG.
- II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 30.12.2024, me Nr. Prot. 838/24-1/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, përmes Znj. Blerina Ramaj - Përfaqësuese Ligjor, lidhur me blerjen e 90 % të aksioneve dhe marrjen e kontrollit të drejtpërdrejtë, nga ndërmarrja SIGAL BUSINESS CENTER Sh.P.K mbi SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.A., përmes UNIQA Osterreich Versicherungen AG.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e dorëzuar, me datë: 27.01.2025;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së, me datë: 27.01.2025;

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro;
3. Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve.

SIGAL BUSINESS CENTER Sh.P.K., është e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikues të subjektit (NUIS) L32202049T. Aktivitet e saj tregtarë kanë të bëjnë me blerjen dhe shitjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, dhënien me qira e pasurive, zhvillimi dhe kryerja e aktiviteteve të shërbimeve, kërkimeve, konsulencës, projekteve dhe studimeve të të gjitha llojeve.

UNIQA Österreich Versicherungen AG, është e regjistruar sipas ligjit të Republikës së Austrisë, me adresë në Untere Donaustrasse 21,1029 Vjenë Austri, me numër regjistrimi: FN 63197. E njëjta është e fokusuar ne tregun e sigurimeve.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.A., një ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar dhe e cila funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikues të subjektit J91809007H, me seli të regjistruar në Bulevardi Zogu I, Nr. 1, 1000, Tiranë, Shqipëri.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit: Tregu i ofrimit të shërbimeve të sigurimeve jetë dhe jo-jetë.

Tregu gjeografik: mund të konsiderohet si treg ndërkombëtar duke përfshire edhe Republikën e Kosovën.

Analiza e Konkurrencës: Në përgjithësi, tregu i sigurimeve në Kosovë, rregullohet dhe mbikëqyret nga ana e Bankës Qendrore të Kosovës-BQK. Si rrjedhojë, edhe procesi i licencimit bëhet nga ana e BQK-së. Bazuar në të dhënat zyrtare, në këtë treg, operojnë një mori ndërmarrjesh që ofrojnë produkte të sigurimit që kanë licencë nga ana e BQK-së.

Ndërmarrja Sigal Uniqa Group në Kosovë, ka pjesëmarrje në tregun e përgjithshëm të sigurimeve jetë dhe jo-jetë, prej 15.05%, sipas të dhënave zyrtare të nxjerra nga “Buletini Statistikor mujor Janar-Dhjetor 2024” të cilin e ka publikuar BQK, me datën 03.02.2025.

Andaj, Autoriteti i Konkurrencës konsideron se ky treg nuk është treg i koncentruar dhe si i tillë nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën dhe konsumatorët. Transaksioni i propozuar nuk do të shkaktojë ndonjë shqetësim për konkurrencën, duke pasur parasysh që Ndërmarrja e Synuar thjeshtë do të ndryshojë aksionarët fundorë dhe në Kosovë nuk do të ketë ndryshime në strukturën aksionare të ndërmarrjeve.

Transaksioni i propozuar nuk do parandalojë, kufizojë ose shtrembërojë konkurrencën në Kosovë, në veçanti nuk do të shpie në krijimin apo përforsimin e pozitës dominuese si dhe nuk do të ketë efekte negative në tregun kosovar.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët në përqendrim, janë prezent në Republikën e Kosovës përmes shitjeve. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës. Filialet e regjistruara të Kompanisë së Kosovës, janë pjesë e tregut në tregun e Kosovës, e cila konsiderohet të mos ketë pozitë dominuese në tregun përkatës të produkteve, që përfshinë 35.4%, të sigurimeve të jetës dhe 16.62% të tregut përkatës, për sigurimet jo-jetë. Shumica e sigurimeve jo-jetë, paraqesin të hyrat më të mëdha. Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencën, respektivisht ky transaksion/blerja, nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**



Nejme Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva